UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesuese e Senatit
Prof.dr. Nurten Deva

Nr. Prot. 2449 Dt 12.10.2026

Senati i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, bazuar në Rregulloren nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini, në Mitrovicë, si dhe Rregulloren nr. 2205, dt.26.09.2025, për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë në mbledhjen e mbajtur më 09.10.2026, mori:

VENDIM

I. Anulohet pjesërisht konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë për vitin akademik 2026/2027, me nr.prot. 2019 dt.03.09.2026.

II. Anulimi i konkursit të shpallur më dt.03.09.2026 bëhet për pozitën si në vijim:

Fakulteti Juridik

1. Një asistent për lëndët: "E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", "E drejta e BE-së", "E drejta ndërkombëtare publike", "Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare", "Tema të zgjedhura nga e drejta e BE-së".

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitën nga pika II bëhet për arsye se asnjëri nga kandidatët e paraqitur nuk i plotëson kriteret formale të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e konkursit, sipas: Rregullores për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM (nr. prot. 1670, dt. 28.09.2021, e plotësuar me Rregulloren nr. prot. 2205, dt. 26.09.2025), veçanërisht neni 7, pika 3.2 (nota mesatare jo më e ulët se 8 në të dy nivelet e studimit) dhe pika 3.3 (mosha jo më e madhe se 30 vjet për angazhim të parë) dhe Rregullores për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik (nr. prot. 3013/1, dt. 21.12.2023), veçanërisht neni 8, pika 1.1 (studimet universitare dhe master në drejtimin përkatës).

Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kandidatët e pakënaqur mund të kontestojnë këtë vendim në Gjykatën kompetente, në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrës për informim me publikun;
4. Zyrës për çështje akademike;
5. Zyrës ligjore;

Prof.dr.Nurten Deva

NDeva

Kryesuese e Senatit